



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

'Saliu i sollti nga veriu në Bathore', Beqiri shpërthen me akuza: Shkaktari i problemeve me pronat është ai
- 2

Jeje në Theth: Magjinë e prish zhvillimi i pakontrolluar, 'Zvicrën e vogël' e keni këtu (VIDEO)
- 3

SHBA i vendos tarifë doganore 50% Kanadasë, vlera e produkteve të prekura arrin gati 20 miliardë dollarë! Hyjnë në fuqi pas 30 ditësh
- 4

Donaldi me shenja në trup, Bora na zbulon arsyen
- 5

Nata e 10 e sulmeve, SHBA godet komandat iraniane! Irani sulmon bazat ushtarake amerikane në Bahrein e Kuvajti! Houthi: Bllokojmë ngushticën Bab El Mande

Kronikë

Atentat në Elbasan/ Plumba drejt një lokali, 3 të plagosur, mes tyre edhe kamerieri! Polici jashtë shërbimit ndoqi autorin, rrethohet lagjia 'Vullnetari'! Gjenden 6 gëzhoja (EMRAT+VIDEO)

Tre persona kanë mbetur të plagosur pas një sulmi me armë në drejtim të një lokali në Elbasan, mes tyre edhe një kamerier. Njëri prej tyre është plagosur në shpatull, ndërsa një tjetër plumbi e ka kapur në këmbë. Nga qëmtimi i vendit të ngjarjes deri tani blutë kanë arritur të zbulojnë 6 gëzhoja.

Atentat në Elbasan/Tre të rinj plagosen me pistoletë në lokal, polici ja
Report TV



Watch on

Redaksia
20 Korrik, 20:52 | Përditësimi: 21 Korrik, 16:06

Share Post



Tre të rinj u plagosën me pistoletë nga një person mbrëmjen e sotme në një lokal të lagjes "Vullnetar" në [Elbasan](#).

Kamarieri [Bjorgi Hoxha](#) 19 vjeç, [Armand Tomorrica](#) 32 vjeç dhe [Renaldo Mance](#) 31 vjeç tashmë ndodhen nën kujdesin e bluzave të bardha. Njëri prej tyre është plagosur në shpatull, ndërsa një tjetër plumbi e ka kapur në këmbë.

Në njoftimin zyrtar të policisë thuhet se në momentin e ngjarjes, në brendësi të lokalit ndodhej një oficer policie jashtë shërbimit, i cili, sapo ka dëgjuar të shtënat, ka dalë menjëherë dhe është vënë në ndjekje të autorit.



LEXO EDHE:
Atentati në Elbasan, 'Ot Kila': Nipi im ka qenë aty rastësisht, nuk ka lidhje

Gjatë ndjekjes, autori ka hedhur armën e zjarrit dhe ka mundur të largohet në thellësi të lagjes. Forca të shumta të Policisë kanë rrethuar zonën në një perimetër të gjerë dhe vijnë kontrollet intensive për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Nga qëmtimi i vendit të ngjarjes deri tani blutë kanë arritur të zbulojnë 6 gëzhoja.

Njoftimi i policisë:

Rreth orës 20:30, në lagjen "Vullnetari", Elbasan, në verandën e një lokali, një shtetas ende i paidentifikuar ka qëlluar me armë zjarri, pistoletë, në drejtim të tre shtetasve: A. T., 32 vjeç, R. M., 31 vjeç, dhe B. H., 19 vjeç, të cilët janë plagosur, jashtë rrezikut për jetën.

Në momentin e ngjarjes, në brendësi të lokalit ndodhej një oficer policie jashtë shërbimit, i cili, sapo ka dëgjuar të shtënat, ka dalë menjëherë dhe është vënë në ndjekje të autorit.

Gjatë ndjekjes, autori ka hedhur armën e zjarrit dhe ka mundur të largohet në thellësi të lagjes. Forca të shumta të Policisë kanë rrethuar zonën në një perimetër të gjerë dhe vijnë kontrollet intensive për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Ndërkohë, grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon veprimet në vendin e ngjarjes për sqarimin e plotë të rrethanave, si dhe për sekuestrimin e çdo prove që do t'i shërbejë hetimit për identifikimin dhe kapjen e autorit.



Atentati në Elbasan/ Karrige të përmbysura dhe

Report TV



Watch on

Share

K.M/E.H/Shqiptarja.com

TAG: [Elbasan](#) [Bjorgi Hoxha](#) [Armand Tomorrica](#) [Renaldo Mance](#)

Komente

- Amistija:** 21/07/2026 07:13

I lironi para kohe se keshtu fillojn dasmat Kush ka vra te kalbet mbrenda jo te boj Gjysmat. Se o do vراسi prap. Ose do e vراسin .se hasmi ate pun ka Do e pres gjakun. Nuk duhet te ket amisti per njer qe kan bo vراسe as gjykim te shkurtuar. Nuk jon budallej amerikanet qe si ulin as dhe nje dit. More nje jet . Dote vuash nje jete. Kaq e thjesht.
- cufi:** 20/07/2026 22:23

RROFSH O EDI RAMA SE NA KENAQE...
- filani:** 21/07/2026 02:02

o cufe lloshja,edi rama nuk eshte as kamarier as qellues e as polic...perse ha tum kot apo koshe nje 2 mnutesh dhe the me veren tende po hedh nja dy rresha?!?!
- Hajdari:** 20/07/2026 23:29

Ore idiot po ju del Rama ne enderr,po pse ore palle edhe per kto Rama e paska fajin or syllesh?po per plakun e rryshk te vicidollit ca duhet te themi atehere?yt trap zalli.

Ndalohej rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016




Sondazhi i ditës: 20 Korrik, 07:09

Territorialja, si e vlerësoni propozimin e PS për më pak bashki dhe ndarje në rajone?

[I drejtë](#) [I gabuar](#) [Nuk e di](#)


Lajme të tjera



4 të plagosur nga atentati në lokalin në Elbasan/ Dyshohet se objektivi ishte nipi i 'Ot Kilës', merret në pyetje! Autori me maskë silikoni dhe paruke

Ronaldo Gjoshi

21 Korrik, 12:14



Kërcënohet gazetari Osman Stafa, 2 persona i prenë rrugën me makinë pasi filmoi nxjerrjen e inerteve në lumin Shkumbin! Të rinjtë vihen nën hetim (EMRAT+VIDEO)

18 Korrik, 07:15



Elbasan/ Tentoi të vriste me thikë 59-vjeçarin, pranga autorit! Arrestohet edhe i plagosuri, nuk dha shpjegime për ngjarjen

17 Korrik, 15:19



Aksident i rëndë në aksin Elbasan-Librazhd, automjeti del nga rruga, humb jetën drejtuesi 19-vjeçar


16 Korrik, 18:47



Muzikë dhe shfaqje artistike/ Elbasani feston me tavën e dheut, krenarinë e gastronomisë

Ronaldo Gjoshi

16 Korrik, 15:10




Përfshihet nga flakët biznesi i 'Neranxi'-t në Elbasan

16 Korrik, 09:33



Kukësi, Gjirokastra dhe Elbasani me rënien më të fortë të punësimit në 2025

15 Korrik, 15:42




Policia e Elbasanit bën bilancin: Gjatë dy muajve të fundit janë kryer 14 operacione, 63 të arrestuar! Hoxha apel drejtuesve: Respektoni rregullat e qarkullimit (VIDEO)

15 Korrik, 12:18




63-vjeçari ndërroi jetë pas aksidentit në Cërrik, reagon shkolla ku punonte: Një mësues i përkushtuar dhe koleg i nderuar

15 Korrik, 08:12



Aksident në Cërrik, humbin jetën shoferi dhe pasagjeri! Makina merr përpara mbrojtëse, përplasat me murin (EMRAT)

14 Korrik, 19:10



Aksident i rëndë në aksin Peqin-Elbasan, përplasen 2 automjete, 5 persona të plagosur

11 Korrik, 20:22



IGJEUM paralajmëron: Sot, situata më kritike nga zjarret! 6 qarqet me rrezik më të lartë


11 Korrik, 16:04

Lajmi i fundit



'Saliu i sollti nga veriu', Beqiri shpërthen me akuza: Shkaktari i problemeve me pronat është ai

21 Korrik, 19:00





**'Saliu i solli nga veriu në Bathore',
Beqiri shpërthen me akuza:
Shkaktari i problemeve me pronat
është ai**

21 Korrik, 19:00